

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË - Departamenti i përgjithshëm - Divizioni civil, në trupin gjykues të përbërë nga Gjykatësi **Drilon HARAÇIA** - Kryetar i trupit gjykues, dhe gjyqtarëve porotë **Xhavit Elezi** dhe **Ismet Këndusi** – anëtar të trupit gjykues, në çështjen juridiko-civile të propozuesit **L. B.** nga Gjakova dhe propozueses **J. B.**, e lindur **A.** nga Gjakova, me bazë juridike zgjidhje e martesës me marrëveshje, në seancën kryesore jo publike, të mbajtur me **dt.19.04.2017**, në prezencën të propozuesit dhe në prezencë të propozueses, mori këtë;

A K T G J Y K I M

I.ZGJIDHET martesa me marrëveshje në mes të propozuesit **L. B.** nga Gjakova dhe propozueses **J. B.**, e lindur **A.** nga Gjakova, e lidhur në Zyrën e gjendjes civile në Gjakovë, me datën 26.09.2008, me numër rendor 669, me numër të referencës 2/2008RM/2001, të lëshuar me datën 21.11.2016, në kuptim të nenit 68 pika 1, të Ligjit për Familjen i Kosovës.

II. Fëmijët e përbashkët – të miturit T. B., e lindur me datë... në Gjakovë, **J. B.**, i lindur me datë..., në Gjakovë, **i besohen në ruajtje, mbajtje dhe edukim nënës së tyre – propozueses J. B. nga Gjakova.**

III. Caktohet Kontakti, ashtu që obligohen propozuesja **J. B.** nga Gjakova që propozuesit **L. B.**, të ia mundësojë kontaktin me fëmijët e mitur **T. B.** dhe **J. B.**, që të dy nga Gjakova dhe në atë mënyrë që çdo të dytën javë (ditën e shtunë prej orës 12:00 deri në orën 14:00 duhet të ia dorëzojë që të mbahet kontakti në mes prindit dhe fëmijëve) ndërsa për pushimet verore dhe dimërore sipas marrëveshjes së propozuesve.

IV. Secila palë i bartë shpenzimet e veta procedurale.

A r s y e t i m

Propozuesit - palët ndërgjyqëse pranë kësaj Gjykate, kanë parashtruar propozim për zgjidhjen e martesës me marrëveshje duke theksuar se kanë lidhur martesë pranë ofiqarit të Zyrës së gjendjes Civile në Gjakovë me datën 26.09.2008, me numër rendor 669, me numër të referencës 2/2008RM/2001. Po ashtu kanë cekur se nga kjo martesë palët ndërgjyqëse kanë dy fëmijë **T. B.**, e lindur me datë... në Gjakovë dhe **J. B.**, i lindur me datë..., në Gjakovë. Tutje kanë theksuar se raportet e tyre janë acaruar në mënyrë serioze dhe të përhershme, raportet e tyre nuk kanë mundësi të rivendosen, ashtu që të njëjtit kanë vendosur që martesën ta zgjidhin në këtë mënyrë.

Propozuesi në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se mbetem në tërësi pranë propozimit për zgjidhjen e martesës së lidhur në mes të propozuesve. Konsideroi se janë plotësuar kushtet e parapara me ligj për zgjidhjen e kësaj martese. Lidhur me besimin e fëmijëve me propozuesen sipas marrëveshjes jemi dakorduar që fëmijët e përbashkët të i besohen propozueses, andaj i propozoi Gjykatës që propozimin për zgjidhjen e martesës ta aprovoi.

Propozuesi në fjalën e tij përfundimtare ka deklaruar se konsideroi se nga provat e administruara dhe rrethanat jo kontestuese janë të plotësuara kushtet ligjore për zgjidhjen e kësaj martese. Po ashtu lidhur me besimin e fëmijëve sipas marrëveshjes me propozuesen kemi arrit marrëveshje që të njëjtit ti besohet në ruajtje dhe edukim, ndërsa sa i përket kontaktit me fëmijët ia lë në vlerësim Gjykatës që të caktoi kontaktin. Propozoi që Gjykata të miratoi propozimin.

- Shpenzimet procedurale nuk i kërkoj.

Propozuesja në shqyrtimin gjyqësor ka deklaruar se mbes gjithashtu pranë propozimit për zgjidhjen e martesës së lidhur në mes të propozuesve pasi që nga ndarja nuk kemi kontakte në mes veti dhe që atëherë martesë ka mbet vetëm në letër. Po ashtu pajtohem me deklaratimet e propozuesit lidhur me mbajtjen dhe besimin e fëmijëve, në atë mënyrë që të njëjtit të më besohen mua si nënë.

Propozuesja në fjalën e saj përfundimtare ka deklaruar se në bazë të provave të administruara dhe rrethanave jo kontestuese rezulton se janë plotësuar kushtet për zgjidhjen e kësaj martesë. Po ashtu lidhur me besimin e fëmijëve pajtohem që të njëjtit të më besohen mua si nënë, ndërsa sa i përket kontaktit ia lë në vlerësim Gjykatës.

– Shpenzimet procedurale nuk i kërkoj.

Gjykata në procedurën e administrimit të provave ka bërë shikimin dhe leximin e Certifikatës së martesës me numër të referencës 2/2008RM/2001 me numër rendor 669, të lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile në Gjakovë me dt.21.11.2016, Ekstraktit të lindjes në emër të T. B. nga Gjakova, me numër serik E21126896, të lëshuar nga Zyra e gjendjes civile në Gjakovë me dt.21.11.2016, ekstraktit të lindjes në emër të J. B. nga Gjakova me numër serik E21126856 të lëshuar nga Zyra e gjendjes civile në Gjakovë me dt.21.11.2016, Raporti i Qendrës për Punë Sociale në Gjakovë Nr.67/17 të dt.21.03.2017, Marrëveshjen e përbashkët të paraqitur në propozimit të datës 27.12.2016 dhe pas vlerësimit të fakteve juridike – relevante të kësaj çështje, çmuarjes me ndërgjegje e të kujdesshme të provave të administruara, rrethanave jo kontestuese të palëve, në kuptim të nenit 8 të LPK, e miratoj propozimin për zgjidhjen e martesës bazuar edhe në nenin 68 pika 1, të Ligjit për Familjen të Kosovës (Ligji nr.2004/32 i publikuar në “Gazetën Zyrtare të Institucioneve të Përkohshme të Vetëqeverisjes në Kosovë” nr.4, të dt.01.09.2004, në tekstin e mëtejme LFK).

Nga provat e administruara u argumentua kjo gjendje faktike:

Nga Certifikatës së martesës me numër të referencës 2/2008RM/2001 me numër rendor 669, të lëshuar nga Zyra e Gjendjes Civile në Gjakovë me dt.21.11.2016, është vërtetuar se palët ndërgjyqëse kanë lidhur martesë me datën 26.09.2008 dhe nga kjo martesë kanë dy fëmijë. Nga ekstrakti i lindjes me numër serik E21126896, të lëshuar nga Zyra e gjendjes civile në Gjakovë, me dt.21.11.2016, në emër të fëmijës së mitur T. B., e lindur me dt... në Gjakovë, vërtetohet se e njëjta është fëmijë i palëve në procedurë, nga Ekstrakti i lindjes me numër serik E21126856, të lëshuar nga Zyra e gjendjes civile në Gjakovë me dt.21.11.2016 në emër të J. B., i lindur në Gjakovë me dt..., vërtetohet se i njëjti është fëmijë i palëve në procedurë. Nga Marrëveshja e përbashkët të paraqitur në propozim të datës 27.12.2016, palët ndërgjyqëse janë dakorduar që fëmijët e përbashkët të i besohen këtu propozueses nënës. Nga Raporti i Qendrës për Punë Sociale në Gjakovë me nr.67/17 dt.21.03.2017, është cekur se procedura e pajtimit në mes të bashkëshortëve ishte e pasuksesshme meqenëse dy bashkëshortët ishin kategorik për prishjen e martesës së tyre me arsyetimin se jeta e tyre e përbashkët për shkak të fjalosjeve të përditshme është bërë e pamundur. Bashkëshortët kanë dy fëmijë dhe janë të pajtimit që të njëjtit të i besohen nënës së tyre J. B., në ruajtje, mbajtje dhe kujdes. Mendimi i organit të kujdestarisë është që të respektohet vullneti i palëve në procedurë që fëmijët ti besohen nënës J. B.-A., në ruajtje, mbajtje dhe kujdes, pasi që kjo është në interesin më të mirë të tyre.

Gjykata në rastin konkret konsideron se janë plotësuar kushtet ligjore të parapara me nenin 69 pika 1, 2 dhe 4 të LFK, sepse martesë e ka humbur qëllimin dhe efektin e vet për të cilin është lidhë. Është fakt se martesë lidhet në bazë të dashurisë, simpatisë, besnikërisë dhe vullnetit reciprok të bashkëshortëve. Mirëpo, meqë në rastin konkret këto elemente qenësore mungojnë, Gjykata konsideron se janë plotësuar kushtet ligjore të përcaktuara me dispozitën e nenit të para cituar, ku janë paraparë shkaqet e shkurorëzimit si shkaqe të përgjithshme dhe

shkaqe të veçanta. Shkaqet e përgjithshme të shkurorëzimit të përcaktuara me nenin 69 par.1 të LFK, parasheh se bashkëshortet mund të e kërkojnë shkurorëzim kur marrëdhëniet martesore janë çrregulluar seriozisht ose në mënyrë të vazhdueshme. Si shkaqe që sjellin çrregullimin serioz të marrëdhënieve bashkëshortore mund të jenë; xhelozia, mos përputhja e karaktereve dhe grindja e vazhdueshme. Ndërsa shkaqet e veçanta janë të parapara në nenin 69 par.2 të LFK, ku përcaktohen si; jeta e padurueshme e bashkëshortëve, shkelja e besnikërisë bashkëshortore, vepra penale kundër jetës së bashkëshortit, keqtrajtimi serioz, ndërprerja e pa arsyeshme e jetës faktike, sëmundja psikike e pa shërueshme etj. Pra, në rastin konkret kjo bashkësi martesore faktikisht ka pushuar së ekzistuari.

Sa i përket çështjes se fëmijës të përbashkët të miturve T. B., e lindur me datë... dhe J. B., i lindur me datën..., kjo Gjykatë vendosi që të njëjtit të ia besoj në ruajtje, mbajtje dhe edukim nënës– këtu propozueses J. B., dhe vendimin e saj e bazoj në nenin 140.2 të Ligjit për Familjen i Kosovës, (Ligji nr.34/2002 i dt.20.01.2006), dhe të deklaramëve të palëve në seancë si dhe duke u bazuar nga Raporti i Qendrës për Punë Sociale për besimin e fëmijëve të mitur. Pra, Gjykata konsideron se vërtetë në rastin konkret është në interesin më të mirë të miturve T. B. dhe J. B., që të njëjtit t'i besohen në ruajtje, mbajtje dhe edukim nënës së tyre – këtu propozueses.

Vendimi mbi shpenzimet procedurale u murr konform nenit 449.1 lidhur me nenin 450 të LPK, dhe deklaramit të autorizuarve të palëve në procedurë.

Nga se u tha më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE GJAKOVË
C.nr.700/16 dt.19.04.2017

Kryetari i Trupi Gjykses,
Gjykatësi
Drilon HARAÇIA

UDHËZIM JURIDIK; Ky Aktgjykim është i formës së prerë pasi që palët në procedurë kanë hequr dorë nga e drejta e ushtrimit të ankesës.